

VENDIM
Nr.694, datë 5.10.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.825, DATË 28.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e anëtarëve të Këshillit të Statistikave, z.Etion Kapedani zëvendësohet me z.Florian Nuri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha